



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KOMUNA PEJË**

**Nr. Protokollit: 400-01/70644**

**Procesverbal i Konsultimit Publik i K.K. Pejë për Buxhet 2025-2027**

**Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Pejës**

**Pjesmarrësit: Banor të Komunës së Pejës**

**Data: 17.09.2024**

**Ora: 12:00**

Takimi u mbajt në Sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin gjithsej 44 qytetar (12 F, 32 M), gjithashtu pjesmarrës ishte nënkryetari i Komunës z. Fatmir Asllani, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, drejtorët nga Ekzekutivi.

Konsultimi Publik për Projekt - buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2025-2027

Në sallën e Kuvendit Komunal të Pejës është mbajtur Konsultimi Publik për Projekt - buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2025-2027.

Konsultimi Publik është organizuar nga Kuvendi i Komunës së Pejës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyra për Informim Publik.

Konsultimin Publik e ka udhëhequr kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, z. Rexhep Kurtbogaj.

I pranishëm në Konsultimin Publik ishte kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj. Diellëza Berisha, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Pejës, znj. Xhenet Syka dhe drejtori për Shërbime Publike në Komunën e Pejës, z. Agron Nikçi, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit z. Naser Gega si dhe grupi për hartimin dhe planifikimin e buxhetit.

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa në Komunën e Pejës, znj.Diellëza Berisha i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se: ndarja e buxhetit bëhet në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ku 10 përqind të të hyrave totale të Kosovës ndahen nëpër komuna dhe pjesa tjetër mbulohet edhe prej të hyrave vetanake! Ne e kemi pranuar Qarkoren e dytë buxhetore me kufijtë buxhetor, pra buxheti i ndarë për vitin 2025 është 39, 842 382. 00 pra është kjo shuma totale e buxhetit, e cila është e ndarë në pesë kategori:

Paga dhe medijtje: 18, 808 949, 00  
Mallra dhe shërbime: 5, 297 000, 00;  
Subvencionet: 1, 200 000, 00;  
Investimet kapitale: 13 481 658, 00;  
Shpenzimet komunale: 1 054 775, 00.

Te kategoria e subvencioneve, prej vitit 2024 kemi një rritje, prej 120 mijë euro, rritja totale e subvencioneve në buxhet është 11.1%. Nga dëgjimet buxhetore, të cilat i kemi mbajtur në qytet dhe në fshatra, rreth 70 % të kërkesave të qytetarëve janë përfshirë në projekt - buxhetin e vitit 2025.

Në vazhdim të pranishmit prezantuan disa kërkesa të banorëve, që mundësisht të përfshihen në kuadër të buxhetit final, para aprovimit në Kuvend.

Njoftimin dhe Projekt-buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2025-2027 mund ti gjeni të publikuara në web-faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

### **Kërkesat e Qytetarëve**

Agim Haxhijaj – Përfaqësues i KL Treboviq

-Ndriçim Publik.

-Asfaltim 630 M.

Mevlyde Idrizi

- Kërkesë për ndërtimin e tregut të bylmetit.

Kadri Mavraj - Pëfaqësues i KL 7 Shtatori

- Mirëmbajtja e ndriçimit publik.
- Ankese të operatoret qe po i zvarritin punimet.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: pasi qe po ndërlihen pyetjet prej 11 operatorëve që i kemi nënshkru kontratat me projektin e MAPL-së edhe Demosit, 4 prej tyre duhet me i ndërpre kontratat sepse nuk kanë punëtorë me punu dhe me i kry punët. Duhet me kuptu një send se kjo shoqëri është në halle të mëdhaja, sespe kompanit nuk kanë njerëz me i kry punët. Ndërsa për tregun e bylmetit ne i kemi bër së paku 7 kërkesa qeverisë, qeveria Hajradinaj e ka pas hjekur prej shitjes dhe ne i kemi kry procedurat për me i bashku parcelat sepse ka qenë një problem aty për bashkimin e parcelave edhe e kemi bër edhe projektin. Projekti është, por qeveria e re e ka anulë vendimin e qeverisë së Hajradinajve, dhe ende nuk i ka kthë përgjigje komunes për me heq nga shitja dhe me ja pagu 20% ashtu siq e ka kërku ligji. Ndërsa, sa i perket ndriçimit janë disa projekte që nuk kemi mujt me i realizu, por i kemi lën me projektet e Grandit të Përformancës, edhe pse ketë here jenë të rrezikuara mos me marr për shkak të kualifikimit të raportit të auditorit. Mirëpo ketë problem e kanë të gjitha komunat edhe pse është fajti i qeverisë që nuk e ka pagu kontraten kolektive por i'a ka bart komunave, dhe komunat me një vendim të gjykatësit janë obligu të gjitha me i pagu kontraten kolektive.

Florian Thaçi – nxënës ne SHME “Ali Hadri”

- Rregullimi i infrastrukturës së brendshme dhe të jashtëm të “Ali Hadri”.
- Ndriçim Publik në Fsh. Novosellë 300 M.

Fitore Haxhihasani – Përfaqësuese e OJQ-ve

- Kërkese për pagesën e Komiteteve Konsultative dhe KKSB-së.

Nazlie Gorani

- Ndërtimi i rrugës në Zatra.

Bejhan Krasniqi – Pefaqësues i KL Karagaq

- Vendosja e laurës ne parkun Karagaqi mos me hy veturat.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: sa i përket pageses së komiteteve në seancen e shtatorit kemi marr vendim me i kompenzu komiteteve konsultative dhe KKSB-së, vendimin ka mar asambleja dhe besoj qe nuk ka me pas pengesa prej ministrisë. Sa i përket shkollës “Ali Hadri” nuk kemi pas investime gjatë ketyre 4 viteve të fundit, mirëpo shkolla ka pas shumë investime prej komunes. Mirëpo një problem që nuk e kemi zgjidhë është se na kemi dasht me mbaru shkollen e re te stacioni i autobusave, mandej e kemi dilem për drejtimin e bujqësisë ka shumë pak nxënës dhe qysh ka me ekzist. Sepse kjo shoqëri ka shumë nevoj për teknik të bujqësisë dhe nuk ka mujt askush me i bind të rinjët që është mirë me u marr me bujqësi. Dhe dilema është se nëse e largojmë shkollen nga aty, athere drejtimi i bujqësisë duhet me u mbyll sepse nuk ka nxënës për me mujt me ekzist si shkollë.

Valdrin Daci- Gazetar Peja në Fokus

- Pagesa për orët shtesë të punës për zjarrfikësit?
- Kur përfundon qendra për trajtimin e qeneve endacak?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: qendra për trajtimin e qeneve endacak është në përfundim, besojmë që deri në fund të muajit tetor është dasht me dorëzu komplet. Ndërsa zjarrfiksat me punë janë në komunën e Pejës, por nën menaxhim të AME-së dhe për punë shtesë ata i lypin mirëpo buxheti më teper nuk ka, kur ka buxhet munden me bo edhe punë shtesë mirëpo ata e kanë edhe një mundësi me mar pushim, kur punojnë më shumë orë marin pushim 2 ose 3 ditë. Sepse ne me ju riparuar veturat, me pagu naften, rrogat me i mar nga komuna, a me u menaxhu prej AME-së, athere diçka nuk është në rregull!

Arben Morina - Pefaqsues i KL Trestenik

- Ndërtimin e kanaleve të ujitjës
- Ndriçimi publik dhe mirëmbajtja tij.
- Trotuar nga shkolla deri te Shala.

Gjatë thirrjes publike për Konsultim publik nuk ka ardhë asnjë kërkesë nga qytetarët në e-mail zyrtarë të publikuar ne njoftimin për Konsultim publik.

Pas diskutimit të gjitha kërkesave kryesuesi e mbylli takimin në ora 13:45 h.

Audio incizimi i këtij takimi dhe lista e pjesëmarrësve janë pjesë e arkivit të Komunës së Pejës.

Procesmbajtësja,

Znj. Donjeta Morina



KRYESUES I KUVENDIT,

Z. Rexhep Kurtbogaj







KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**LISTA E NËNSHKRIMEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK, ORGANIZUAR NGA KUVENDI  
I KOMUNËS SË PEJËS PËR DRAFT-BUXHETIN E KOMUNËS SË PEJËS 2025-2027**

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Pejës

Pjesmarrësit: Qytetarë, OJQ, Grupet e Interesit, Klubet Sportive.

Data: 17.09.2024

Ora: 12:00

Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
1	AGIM HAKHJAJ	K.L. TREBOVIQ	
2	Firdere B. Ukaj	Prishtinë / Solidar Suisse SET	
3	Edon Baligi	Prishtinë / Solidar Suisse SET	
4	Argjentin El-zaj	Detyrë e detyrës / Shkollë Ali Hadri	
5	Alisa Ademaj	Pejë / Shkollë Ali Hadri	
6	Florian Thaci	Pejë / SHME "Ali Hadri"	F. Thaci
7	ALBAN MAJLIQI	SOLIDAR SUISSE	
8	BEJHAN KRASNIRI	K.B.L. - KARMAN	
9	MUHAMET BEJHAN	K.L. KRYSITEC	
10	OSMANI MULLIQI	K.L. PAUPUS	
11	ADRIAN TRAJKOSI	PEJE	
12	HODI BARDHANI	Sh. i vogël	
13	MASER DEVAJ	PEJE	
14	LUAN PAVAJ	PEJE	
15	Sabrina Mihaljević	Pejë / OSCE	
16	Fidan Gafur	OSCE / RC PE	
17	Astrit Krasniqi	Pejë	
18	XHAVIT. KASTRATI	DOBRODOL.	Xh. KASTRATI





Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	VENDBANIMI/ORGANIZATA	NËNSHKRIMI
-----	------------------	-----------------------	------------

19	FISNIK BERISHA	DARDANUJA 3	
20	Fitore Haxhibasani	Pejë	
21	Donjeta Monina	KK - Pejë	
22	Diellza Bruhimaj	Pejë/Alti Hadri	
23	Sqerret Bajrami	Kri / Shkollë e re	
24	ALBAN MALIQI	SOZIPAR SUJST	
25	Nasir Gani	Qendra për Zëtra	
26	SHPEKUSALIHAT	DARDANIA - I -	
27	BEJHAN KRASNIQI	K-B-L-KHAGAR	
28	KADRI MAMROJ	KL. 7 Shtator	
29	Muhamet Berishaj	KL. KËMISHEC	
30	Oskan Mulla	KL. Pouslug	
31	Valdrin Daci	Pejë/Alti Follor	
32	ARBEN MORINA	TRASTHIC	
33	MELYDJE IDEJAI	DYLETURIC	
34	Jozuf Haxheraj	Pejë - 7 - Shtator	
35	Naser Gërv	DIKA - PËJË	
36	GEORGE TRUKA	DBF - PËJË	
37	Fatmir Tuzar	DBF - Pejë	
38	Diellza Bruhimaj	DBF - Pejë	
39	GAZEMO MUKAJ	— II —	
40	Xhenerit Syri/Kmedhi	DKRS	
41	Agon Nisaj	DPKSHP	
42	Florinda Berisha	KK - Pejë	
43	KEJHAN KURDUBAJ	KK PEJË	
44	AVNI GASHI	KK - Pejë	
45			
46			
47			
48			
49			

